



Republika e Kosovës
Republika Kosovo-Republic of Kosovo
Kuvendi - Skupština - Assembly

Legjislatura IV
Sesioni Pranveror

Komisioni për Punë të Jashtme
Mbledhja nr. 13
Prishtinë, më 5 shtator 2011, në orën 11:00
Ndërtesa e Kuvendit, salla N-302

P r o c e s v e r b a l

I mbledhjes së Komisionit për Punë të Jashtme

Në mbledhje morën pjesë: Albin Kurti, Hydajet Hyseni, Shaip Muja, Skender Hyseni, Sabri Hamiti, Donika Kadaj- Bujupi, Amir Ahmeti dhe Petar Miletij.

Mungoi: Enis Kervan.

Pjesëmarrës të tjerë: Lejla Selimi– OSBE, Lumnije Murati- ZPRK, Besnik Ramadanaj- KDI dhe Dardane Neziri - media.

Nga Zyra e Komisionit: Minire Hasani dhe Manush Krasniqi.

Mbledhjen e kryesoi: Albin Kurti - kryetar i Komisionit.

Në këtë mbledhje u propozua ky

R e n d d i t e:

1. Miratimi i rendit të ditës;
2. Miratimi i procesverbalit të datës 27 korrik 2011;
3. Plani i veprimit të Kuvendit për integritet evropian;
4. Shqyrtimi i Projektligjit për marrëveshjet ndërkombëtare;
5. Të ndryshme.

1. Miratimi i rendit të ditës;

Kryetari konstatoi se Komisioni e miratoi rendin e ditës.

2. Miratimi i procesverbalit të datës 27 korrik 2011;

Kryetari konstatoi se Komisioni e miratoi procesverbalin e datës 27 korrik 2011.

3. Plani i veprimit të Kuvendit për integritet evropiane;

Albin Kurti i njoftoi se mbështetur në Planin e veprimit të Kuvendit për integritet evropiane për vitin 2011, për Komisionin gjatë tremujorit të tretë dhe të katërt janë propozuar të ndërmerren disa veprime sipas pikës P. 54 të këtij plani. Pika e parë tha se parasheh organizimin e një dëgjimi në Komision me ministrin për të prezantuar strategji gjithëpërfshirëse për përfaqësim të jashtëm, si dhe për anëtarësim në organet ndërkombëtare dhe organizatat; pika e dytë ndërlidhet me pikën e parë; pika e tretë të hartohet plani nga administrata e Kuvendit dhe të ndahen mjetet buxhetore për hapjen e zyrës së Kuvendit të Kosovës në Parlamentin Evropian; pika e katërt të forcohet diplomacia parlamentare me qëllim të vendosjes së marrëdhënieve kontraktuale me Bashkimin Evropian dhe gjetjes së zgjidhjes për përfaqësimin e jashtëm të Kosovës në iniciativat rajonale, me theks të veçantë në CEFTA, dhe pika e pestë, kërkohet një raport me shkrim nga Qeveria e Kosovës lidhur me mundësinë e aplikimit të Kosovës në Këshillin e Evropës.

Pikat: 1, 2 e 5 të P. 54 të Planit të veprimit të Kuvendit tha se janë të realizueshme nga Komisioni, përderisa pikat 3 e 4 duhet diskutuar për kompetencën e tyre, çështjet buxhetore dhe administrative.

Sabri Hamiti - Duke u ndërlidhur me pikat e parapara për Komisionin nga Plani i veprimit të Kuvendit për integritet evropian tha se pikat: 1, 2 e 5 janë realizueshme nga Komisioni. Lidhur me pikën për hapjen e zyrës së Kuvendit të Kosovës, në Parlamentin Evropian tha se është ide e kamotshme. Është biseduar edhe me z. Eduard Kukan, udhëheqës i grupit të Parlamentit për Evropën Juglindore dhe Kosovën, për gjetjen e një rruge që Kosova të jetë shumë më e pranishme në Bruksel. Sa i përket mundësisë së aplikimit të Kosovës në Këshillin e Evropës, kjo çështje ka qenë temë debati në Komision dhe në Kuvend, ku ishte menduar se nuk mund të aplikohet për anëtarësim në Këshillin e Evropës pa siguruar mbështetjen e nevojshme. Për këtë pikë duhet kërkuar raport me shkrim nga Qeveria e Kosovës për mundësinë e aplikimit të Kosovës në Këshillin e Evropës.

Hydajet Hyseni - Mbështeti pikën lidhur me hapjen së zyrës së Kuvendit të Kosovës në Parlamentin Evropian, të cilën çështje nuk e konsideron veprim vetëm të Komisionit për Punë të Jashtme. Po ashtu edhe për çështje rajonale, përkrahu ndërmarrjen e nismave nga Komisioni në konsultim me subjektet e tjera parlamentare.

Skender Hyseni - Hapja e zyrës së Kuvendit të Republikës së Kosovës në Parlamentin Evropian tha se është çështje krejtësisht politike. Në Parlamentin Evropian, Kuvendi mund të ketë përfaqësues, si çdo vend tjetër, por nuk mund të ketë zyrë. Lidhur me aplikimin e Republikës së Kosovës për anëtarësim në Këshillin e Evropës tha se kjo kërkesë ekziston e shkruar qysh nga koha kur ishte ministër në MPJ- së. Kjo është një çështje që kërkon ende kohë, dhe një analizë më të hollësishme dhe më të kujdesshme.

Hydajet Hyseni - Sa i përket kompetencës së komisioneve për ndërmarrjen e veprimeve nga Plani i veprimit theksoi se komisionet e tjera mund t'i qasen këtyre detyrave nga aspekti i tyre funksional, ndërsa Komisioni ynë nga aspekti i politikës së jashtme. Propozoi që Komisioni të përgatisë ndonjë formë të komunikimit ndërparlamentar, tryezë ose konferencë për çështjet që i konsideron prioritare, siç është çështja e bashkëpunimit rajonal.

Sabri Hamiti - Ceku se organizimi i Konferencës rajonale nga Komisioni, është konsideruar i suksesshëm dhe ka pasur efekt të madh politik. Kjo konferencë mund të vazhdohet dhe të hyjë si

prioritet në programin e Komisionit, pasi që dy ose tri komisione rajonale janë të interesuara të vazhdojnë me organizimin e saj. Duke u ndërlidhur me çështjen e aplikimit të Kosovës në Këshillin e Evropës tha se në cilësi të Komisionit parlamentar është mirë të shikohet mundësia se në çfarë forme do të mund të ishim të pranishëm në Asamblenë Parlamentare të Këshillit të Evropës.

Pas diskutimeve të anëtarëve të Komisionit, kryetari konstatoi se Komisioni nxori këtë

P e r f u n d i m

1. Komisioni do të angazhohet për përmbushjen e veprimeve të propozuara nga Plani i veprimit të Kuvendit për integrim evropian, për vitin 2011.

2. Të ftohet ministri Enver Hoxhaj për dëgjim në Komision për të prezantuar strategji gjithëpërfshirëse për përfaqësim të jashtëm, si dhe për anëtarësim në organet ndërkombëtare dhe organizatat sipas pikës 1 të P. 54 të Planit të veprimit të Kuvendit. Takimi të mbahet gjatë javës së tretë ose të katërt të shtatorit, varësisht nga agjenda e ministrit që të prezantoj në Komision lidhur me këtë çështje.

4. Shqyrtimi i Projektligjit për marrëveshjet ndërkombëtare nr. 04/L-52;

Anëtarët e Komisionit diskutuan lidhur me Projektligjin për marrëveshjet ndërkombëtare nr. 04/L-52, të miratuar në parim më 23 gusht 2011 dhe vlerësuan nevojën e angazhimit të një eksperti për shqyrtimin e këtij projektligji, duke u mbështetur në listën e ekspertëve për mbështetjen e punës së Komisionit.

Pas diskutimeve të anëtarëve të Komisionit, kryetari konstatoi se Komisioni nxori këtë

P e r f u n d i m

Angazhohet prof. dr. Zejnullah Gruda në cilësi të ekspertit për të shqyrtuar dhe ofruar rekomandime për ndryshim - plotësim të Projektligjit për marrëveshjet ndërkombëtare.

5. Të ndryshme.

Albin Kurti i njoftoi anëtarët e Komisionit se lidhur me vizitën zyrtare në Shqipëri, është në kontakt me z. Fatos Beja, kryetar i Komisionit për Politikë të Jashtme për përcaktimin e datës për realizimin e vizitës gjatë fundit të shtatorit ose fillimit të tetorit. Po ashtu njoftoi se Grupi punues për mbikëqyrjen e Ligjit për Ministrinë e Punëve të Jashtme dhe Shërbimin Diplomatik të Republikës së Kosovës është në pritje për takim me një ose dy deputetë, të cilët kanë rastisë të gjenden këtu.

Mbledhja përfundoi në orën 12:00.

E përgatiti:

Njësia për Mbështetjen e Komisionit

Kryetari i Komisionit

Albin Kurti